



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

### V E N D I M

Nr. 21/2, DATË 20/11/ 2017

#### **PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK “AGROCON”**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18, 21 dhe 34 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë, vlerësoi:

- Vlera e investimit të projektit “Agrocon” tëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 5,832,000 € (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë Euro).
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës të operimit, numri i personave të punësuar do të jetë 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) persona.
- Projekti do të realizohet nga subjekti “Agrocon Albania shpk”, NUIS/NIPT: L324060240.
- Projekti parashikon realizimin e një ferme bujqësore për kultivimin e perimeve në ambjente të mbrojtura, të mbyllura e të hapura, dhe realizimin e një magazine të grumbullimit të perimeve, në Fshatin Ngurrës e Vogël, Komuna Krutje, Rrethi Lushnje. Për realizimin e këtij projekti, Subjekti Agrocon Albania shpk, NUIS/NIPT: L324060240 ka nënshkruar Kontratë Qiraje Nr. 919 Prot., datë 31.01.2015 për 90 vite, me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë.
- Projekti ka Leje Ndërtimi Nr. Prot. 833/1, datë 01.02.2016 për zhvillimin e objektit “Magazininim, grumbullim, paketim perimesh të prodhuara nga aktiviteti” për ZK. 2790, nr.pasurie 153, sipërfaqe 3007.92m<sup>2</sup>.

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar” për projektin e investimit Agrocon, sipas kushtit të parashikuar në nenin 34, pika 2 të Ligjit 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit Agrocon jepet me afat 1 (një) vjeçar, në përputhje me afatin e lejes së ndërtimit të projektit Nr. Prot. 833/1, datë 01.02.2016 për zhvillimin e objektit “Magazinin, grumbullim, paketim perimesh të prodhuara nga aktiviteti” për ZK. 2790, nr.pasurie 153, sipërfaqe 3007.92m<sup>2</sup>.
2. Projekti duhet të pajiset me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe lejen përkatëse mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dispozitat e përcaktuara në Kreun VII të Ligjit 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” mbi masat mbështetëse, nuk aplikohen për kontratat e investimeve të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.
4. Projekti i investimit Agrocon përfiton procedurat administrative të përshpejtuara mbi zgjidhjen e problematikës së ndodhur gjatë regjistrimit fillestar për parcelat e paregjistruara në ZK. 2790, referuar Kontratës së Qirasë Nr. 919 Prot., datë 31.01.2015, duke qenë se pasuria është objekt i legjislacionit në fuqi për qiranë e tokave bujqësore në pronësi të shtetit.
5. Ky vendim miraton dhe planin e veprimit mbi masat mbështetëse të kërkuara nga Shteti Shqiptar dhe miratuar me vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike. Plani i Veprimit i bashkëlidhet këtij vendimi.
6. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Agrocon” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
7. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
8. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**SENIDA MESI**

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

**PLANI I VEPRIMIT**  
**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK AGROCON**

**1. Përmbajtja e planit të veprimit**

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;

**Zbatimi i planit të veprimit**

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

**2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit AGROCON**

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit Agrocon përcakton masat dhe procedurat në lidhje me lehtësimin e procesit për regjistrim fillestar të parcelave Nr. 155 dhe 157 në ZK. 2790, Krutje, Lushnje, referuar Kontratës së Qirasë Nr. 919 Prot., datë 31.01.2015 ndërmjet subjektit propozues dhe MBZHRAU.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga Shteti Shqiptar, për realizimin e investimit.

Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

### 3. Hapat procedurale

Propozimi nga investitori:

Subjekti Agrocon Albania shpk, NUIS/NIPT: L324060240 kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Në zbatim të nenit 34, pika 2 të të Ligjit 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si vijon:

Masat e kërkuar	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza.	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Regjistrim fillestar nga ZRPP Lushnje i parcelave me Nr. 155, 157 të marra me qira nga Subjekti Agrocon Albania shpk, NUIS/NIPT: L324060240 referuar Kontratës së Qirasë Nr. 919 Prot., datë 31.01.2015 ndërmjet subjektit propozues dhe MBZHRAU.	PO	<b>MBZHR</b> si institucion pretendent me të drejta reale mbi pasurinë e palujtshme  <b>ZVRPP LUSHNJE</b>	Ligj Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, Neni Nr.25 regjistrimi fillestar i pasurisë. - Neni Nr. 193 i Kodit Civil;	Dokumenti që vërteton të drejtat reale të administratorit të pasurisë së palujtshme.  Një plan rievimi të pasurisë, të përgatitur nga një subjekt i licencuar për punime topografike, sipas kërkesës së të interesuarit apo nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	Kërkesa trajtohet me prioritet nga MBZHR dhe ZVRPP Lushnje	Nuk ka
Regjistrim në ZVRPP Lushnje i	PO	<b>MBZHR</b> si institucion pretendent	Ligj Nr. 33/2012 “Për regjistrimin e	1.Kontrata e qirasë e lidhur me institucionin	Kërkesa trajtohet me prioritet nga	Nuk ka

<p>Kontratës së Qirasë Nr. 919 Prot., datë 31.01.2015 , për të gjitha parcelat e marra me qira nga subjekti Agrocon Albania shpk, NUIS/NIPT: L32406024O</p>		<p>me të drejta reale mbi pasurinë e palujtshme</p> <p><b>ZVRPP LUSHNJE</b></p>	<p>pasurive të paluajtshme”, Neni Nr. 51 Regjistrimi i kontratës së qirasë;</p> <p>-Neni Nr. 826 i Kodit Civil;</p> <p>-Ligji nr. 8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” Neni nr. 17 I ligjit të sipërcituar.</p>	<p>qiradhënës( BQ TB pranë MBZHRAU );</p> <p>2.Plan vendosjen e parcelave e hartuar nga një subjekt i licensuar për punime topografie;</p> <p>3.Lista e parcelave të marra me qera të firmosura nga autoriteti qiradhënës.</p>	<p>MBZHR dhe ZVRPP Lushnje</p>	
---	--	---	--	--	--------------------------------	--

**ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

SENIDA MESI